



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe ansferte, nr. 01/111-400 të datës 28 maj 2012 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, Vendimin e Kuvendit të Komunës për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore 2021-2020, nr. 01-400/-03-0075925/19,

në implementimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me nr. prot. 02-320/01-0067128/20 datë 05.11.2020 e lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe Organizatës për Zhvillim Rural "Mëshqerra", bën:

FTESË PUBLIKE

Për aplikim në projektin:

➤ **Mbështetje fermerëve blegtorë me nga një mëshqerrë (lopë) barrëse (Raca Hollshtajn)**

Projekti do të realizohet në bashkëfinancim me Organizatën për Zhvillim Rural "Mëshqerra" dhe fermerët përfitues.

Në kuadër të projektit përfshihen fermerët të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret:

- Të jetë banor i Komunës së Podujevës (kopja e letërnjoftimit)
- Vërtetimi i tatimit në pronë
- Vërtetimi nga AVUK për numrin e krerëve të lopëve.
- Të posedoj stallë adekuate që i plotëson kushtet sipas standardeve.
- Të posedoj 3 deri 10 krerë të lopëve në mbarshtim.
- Të posedoj më shumë se 2 ha tokë të punueshme bujqësore.

Mbështetja /Subvencionimi do të bëhet për një krer lope për fermer dhe realizohet përmes formës së participimit financiar nga ana e fermerëve me pjesëmarrje **13.80%** të vlerës së projektit (për një krer lope), të cilët para lidhjes së kontratës do të bëjnë pagesën në llogarinë bankare të Komunës, shumë e cila do ju kthehet fermerëve në tri vitet e ardhshme përmes ushqimit të koncentruar dhe imputeve tjera, shërbimeve veterinerë dhe trajnimeve për fermerë.

Komuna do të marrë pjesë me **27.58%** të vlerës së projektit, ndërsa

Organizata për Zhvillim Rural "Mëshqerra" do të marr pjesë me **58.62 %** të vlerës së projektit.

- Afati i aplikimit: nga data **05.11.2020 deri më 17.11.2020.**
- Aplikacionet dorëzohen në Qendrën e shërbimit për qytetarë, objekti i ri i Komunës, kati përdhësë, në sportel.

Nr.prot. 12-320/01-0067193
Podujevë, 05.11.2020



Drejtori
Dr. Vezir Januzi